

KOMPOZICIONI I RRËFIMIT PËRMES NGJYRIMEVE DRAMATIKE

Romani: "1803"
Autor: Besim Xhelili
Redaktore: Violeta Allmuça
Recensentë: Prend Buzhala, Engjëll I. Berisha
Botoi: Botimet FISHTA

Prishtinë, 2016

Rrëfimet ngrihen zakonisht mbi një subjekt të përbashkët, që herë-herë subjekti përfshin brendapërbrenda ngjarje, episode, mjedise, personazhe, qoftë nga përjetimet e drejtpërdrejta të vet autorit, qoftë përmes gërshetimit të ngjarjeve mes reales dhe sureales, gjegjësisht ndërtimit mbi fantazinë e autorit.

Besim Xhelili, autor i romanit "1803", është vet rrëfimtari, përkatësisht personazhi episodik, i cili varion mrekullueshëm në skenat e përshkruara, me një laryshi trajtash përgjatë rrëfimit. Përsonalja dhe imagjinaria janë të komponuara përputhmërisht gjatë shtrirjes lineare të ndërtimit të personazheve e skenave në hapësirë, sikur edhe diferencimit pa e humbur narracioni ekuivalencën dhe intensitetin.

Shtrohet pyetja, çfarë janë dimensionet në paralelet e fushëveprimit të romanit "1803"?

Gjithsesi, kujtoj, gjatë zhytjes në ngjarjet rrëfyese, lexuesi psikologjikisht do të kalojë si nëpër "rrathë purgatori"! Aty gjejmë shfaqje romantike, dashuri, lot, krim, intriga, tradhti, humanitet,...etj.; që do të thotë është një pentagram me ngjyrim dramaticiteti që mëtojnë nëpër valët e jetës. Ndalemi për një çast tek skenat e dashurisë, me shfaqjen e dy personazheve kryesore këtu: Besarit dhe Samirës. Që nga njohja e tyre e parë nga një rastësi, mbase nuk thuhet së koti se "rasti është mbret i botës", lidhja e tyre identifikohet si një simfoni e pambarim, përkundër gatishmërisë për sakrificë nga ana e Besarit (mbase të dy personazhet në fjalë, tani më kishin familjet e tyre, sikur edhe fëmijë), por piktorja symagjike e ka të pamundur, përkatsisht nuk është parapërgatitur për një ri-kurorëzim, deri sa është e gatshme të ruajë një lidhje të përhershme jashtëmartesore. Këtë ia dëftonin tingujt e zemrës tani. Gjendja shpirtërore e

saj aktualisht është reflektim i ftohjes së raporteve mes saj dhe bashkëshortit. Interesante është se të dy vijnë nga fusha e artit, deri sa Besari merret me krijimtari letrare, ndërkaq Samira është një piktoe e spikatur dhe me nam në botën perëndimore, ku ajo jeton e vepron. Të dy jetojnë në botën mërgimtare, por në shtete të ndryshme europiane. Megjithatë, distanca gjeografike sikur e rrit magnetizimin e dy poleve shpirtërore, që për ideal kanë saldimin e të dy zemrave të tyre. Ja një citat i shkëputur nga Kapitulli i -V-:

"Para se të nisem për në punë hapa një kuti të madhe që e kam me shkrime të vjetra dhe gjeta një letër:

LETËR VUAJTJESH...

Nuk e di në do të besosh sa rëndë e kam të të kujtoj, të marrë durimin e t'i bashkoj të gjitha forcat e mia të të shkruaj letër, letër që është një tronditje e shpirtit tim, një turbullim i mendimeve të mia, një zhytje në dehjen frymëzënëse, një rrugë për në vuajtjet e pafund. Megjithatë, një vrull shpirtëror dhe një rizgjim freskues i zemrës, më rilind vetëdijen, dhe edhe pse me lot të zjarrtë që më përvëlojnë fytyrën, për shkak se jam i pikëlluar dhe i lënduar në brendi, më jep guxim dhe instinktivisht i urdhëron dorës mëkatore të të shkruajë një letër përshëndetëse, të të tregojë se ndjej mungesë të madhe, shpirtërisht jam shumë i vvarë... "

Nisur nga realja pra, në romanin "1803" na shpërfillen elemente kyçe mes kombëtares, që do të thotë, traditës, kulturës, dokeve dhe zakoneve, etj.; dhe ndërkombëtares, që për fiksim është bota perëndimore ku jetojnë e veprojnë të dy kryeprogonistët e ngjarjes në roman. Psikologjinë e të dy personazheve, më gjithë kulturën e arrirë dhe integrimin social në shtresën perëndimore, prapë na shfaqen përshkrime me ngarkesa, mbase edhe me trauma nga jeta djaloshare e Besarit, që do kuptojmë shumë vonë për këtë ndodhi të befasishme. Periudhë që ndryshe është analoge me dramën Çajupiane "14 vjeç dhëndër", pra për nga mosha, por tërësisht në rrethana tjera apo më konkretisht në rrethana të dhunshme. Dhuna, padyshim lenë gjurmë të pashlyeshme tek individi, që në shkencë njihet me terminologjinë **traumë**, e që **trauma** kërkon trajtim adekuat mjekësor në botën perëndimore, gjersa në mentalitetin e shoqërisë tonë nacionale, as që guxon ta shpalosësh, të pakten deri tash...

Proza e gjatë, siç njihet ndryshe romani i autorit Besim Xhelili, të shumtën e rasteve e përshkruan dialogu, por jo pas mbetet edhe meditimi individual si trajtë e veçantë e monologut. Kompozicioni i rrëfimit në romanin "1803", nisët nga ndërtimi i imazheve, tabllove, që na dalin si origjinale rrjedhimisht përmes ngjyimeve të qarta dramatike, vijëzimeve e përshkrimit të raporteve në mënyrë të stërholluar. Të shkëpusim një dialog mes personazheve:

"Gëzohem aq shumë që të shoh, vërtet gëzohem, më beson?", - i thashë disi me vonesë pasi më erdhën pak mendtë.

"Besoj, besoj. Aq më shumë gëzohem edhe unë. U bë kohë e gjatë që nuk jemi parë", - tha ajo me sytë plotë xixa.

Këto xixa ndezën diçka me vrull në brendinë time, e që nuk gjeta kurrë mënyrën si ta shuaj këtë zjarr të furishëm.

"A je vetëm apo me dikë",? - e pyeta unë pasi u ndava nga përqaqimi me të dhe pasi arrita, nuk e di se si ta merrja pak veten e t'i qetësoja ndjenjat, që më vlonin e nuk besoja se jam pjesë e këtij realiteti.

"Po! Vetëm jam, - ma ktheu ajo. Nga Shkupi erdha me bashkëshortin dhe fëmijët, por ata nuk deshën të vijnë në bibliotekë, - vijoi Samira. Ti e di se unë dhe ai nuk jemi aspak të njëjtë sa u përket këtyre gjërave, ai është tërësisht një tip tjetër e unë e gjitha diçka tjetër, thua asgjë nuk kemi të përbashkët, por ja...", - u përgjigj ajo.

"Po, ashtu është gati tek të gjithë, - ia ktheva. Ja, edhe unë gjithmonë nëpër këto aktivitete jam vetëm, pa gruan, por, të kam ty tash për shoqërimi apo...", - u përgjigja dhe pyeta unë njëkohësisht."

Pra, dialogu qëndron brenda strukturës psikologjike të personazheve, karshi botëkuptimeve dhe mentaliteteve të nivelit mes dy shtresave, dy kulturave, dy botërave disproporcionalisht të ndryshme, përkatësisht, të paekuilibruara sociologjikisht. Të gjitha këto skena, jo që mund t'i shprushni vet (kuptohet gjatë leximit të romanit "1803") dhe të identifikoheni me ndonjërin nga personazhët e romanit në episode specifike, por bota juaj shpirtërore sikur edhe intelektu juaj (pra lexuesve me këtë rast), do pasurohet e fisnikërohet në masë. Kjo, mbase gjuha është standarde, e kuptueshme dhe krijon relacion të përafërt me lexuesin..., për të konkluduar se e përvetëson lexuesin pasionant shpejt. Krejt për fund do citoj vargjet që Besari i shkruan me ngjyrën e shpirtit e Samira i deklamon me ngjyrën e zemrës, sikur këto, citoj:

" I dërgova disa vargje:

*"Sonte me ëndrrën tënde do të kacafytem
Si fitimtar nuk besoj se dal,
Me sytë e tu në ekstazë do të mbytem
Do zmbrops epshin që është bërë si mal".*

Më pas, thotë Besari, vazhdova:

*"Në kulmin e asaj që digjet
Me dolli do festojmë armëpushimin,
Buza jote me timen do të ngjitet
Me djersë do pushtojmë mallëngjimin". "*

Me këto vargje e përmbyllë fjalën time rreth romanit "**1803**", duke i dëshiruar Besimit aventurë të mëtejme në shtjellimin e romaneve në vijim, qoftë edhe vazhdimit të romanit "**1803**", me gjithë peripetitë, përjetimet, hiperbolizimet e parabolizimet që mjeshtrosh i shtjellon autori Besim Xhelili.

Koblenz, korrik 2016

Hasan Qyqalla